



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:053820

Datë: 17.10.2018

Numri i dokumentit: 00153665

P.nr. 874/14

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA  
VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
DHE I Detyrues  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ I UROŠEVAC

05.12.2018

NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, në përbërje nga gjyqtari individual Adem Shabani, me zyrtaren ligjore Kadishe Shabani, ka proceduar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2316-4/2013 e datës 12.08.2014, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED], nga Ferizaj rruga " [REDACTED] " nr. [REDACTED] për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga nenin 327 par.1 nën paragrafi 1.1 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurores së shtetit Mimoza Sylja, të dëmtuarit [REDACTED] dhe të pandehurit [REDACTED] më dt.17.10.2018 mori dhe publikisht shpall këtë:

**AKT GJYKIM**

I pandehuri [REDACTED] nga Ferizaj rruga " [REDACTED] ", i lindur me datën [REDACTED] në Fshatin [REDACTED] Komuna Ferizaj, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike,-

**ËSHTË FAJTOR**

**SEPSE:**

- Me datë 11.10.2013, rreth orës 22:20, në rrugën " Kongresi i Lushnjes " , në Ferizaj, me qëllim të përvetësimit të sendeve të huajave të luajtshme, e që vetit ti sjellin përfitim pasurorë në mënyre të kundërligjshme, me mjetë të përshtatshëm ka eliminuar pengesat ka hapur një dritare përmes të cilës ka depërtuar brenda, ku në katin e dytë në dhomën e fjetjes së djalit të dëmtuarit [REDACTED], nga aty ka marrë: 2 rrathë dore, 4 unaza, 2 zingjir qafës stoli prej ari, ndërsa stoli agjenti ka marrë 1 një palë vath, 2 zingjir qafe, 2 unaza, dhe një rreth dorë, dhe një telefon të markës " Samsung " , ka hyrë në dhomën e të dëmtuarit [REDACTED] i cili ishte duke fjetur me një bateri në dorë, mirëpo është vërejtur nga i dëmtuari me ç' rast me vrap i

pandehuri është larguar nga aty, vlera e dëmit të shkaktuar sipas të dëmtuarit sillet prej 1500 Euro,-

*- me të cilën ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga nenin 327 par.1 nën paragrafi 1.1 të KPRK-së.*

Gjykata në bazë të dispozitës së lartë përmendur dhe nen. 4, 7, 17, 41, 42, 43, 45, 46, 49, 50, 51, 52, të nenit 75 dhe 76 par 1 nën par 1.3 dhe 73 të KPRK-së dhe nen. 365 të KPPK-së :

## G J Y K O N

Të pandehurin [REDAKTUAR] i shqipton:

**I. a)** - me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti të cili dënim do të vuaj pasi aktgjykimi të merre formën e prerë, nën kërcenim të ekzekutimit me dhunë , dhe

**b)** - dënim me gjobë në shumë prej 400 / katërqind / Euro, dhe në të njëjtën kohë urdhëron që dënimet me gjobë të mos ekzekutohen nëse i akuzuari në kohën prej 1 / një / viti pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë nuk do të kryej vepër tjetër penale.

**II.** Obligohet i akuzuari [REDAKTUAR] që të dëmtuarit [REDAKTUAR] nga Ferizaj, rruga [REDAKTUAR] , që ti a kthej sendet e vjedhura ose në të kundërtën t'ia kompensoj kundërvlerën në të holla në shumë prej 1500 Euro,-

**III.** Obligohet i akuzuari, të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej nga 20 (njëzetë) Euro, dhe taksën në shumën prej 30 Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP. nr. PP/II.nr.2316-4/2013 e datës 12.08.2014, ka akuzuar [REDAKTUAR], nga Ferizaj rruga " [REDAKTUAR] " nr. [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga nenin 327 par.1 nën paragrafi 1.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë 17.10.2018 në të cilën përfaqësuesi i akuzës – prokurorja e shtetit Mimoza Sylja, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e shqyrtuara në shqyrtimin gjyqësor dhe dëgjimin e të dëmtuarit Rrahim Shabani dhe dëshmitarit Blerim Aliu, është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktakuzës i propozoj gjykatës që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

Në shqyrtimin gjyqësor i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 323 par.1, par.2 nën par.2.1, 2.2, 2.3 të KPRK-së se duhet të përcjellë me vëmendje zbatimin e shqyrtimit gjyqësor se ka të drejtë të mos deklarohet lidhur me çështjen e tij ose të mos përgjigjet në asnjë

pyetje, nëse deklarohet ai nuk detyrohet të inkriminoj veten apo të afërmit e tij e as ta pranoj fajësinë, ai mundë të mbrohet personalisht apo nëpërmjet ndihmës juridike të mbrojtësit sipas zgjidhjes së tij.

Pas leximit të akuzës nga ana e prokurores së shtetit gjyqtari është bindur se i akuzuari e ka kuptuar akuzën dhe të drejtat të cilat i takojnë, të njëjtit i ka afruar mundësinë të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën për të cilën është akuzuar.

I akuzuari [REDAKTUAR] në mbrojtjen e tij në shqyrtimin gjyqësor është deklaruar në tersi si i pafajshëm, duke shtuar se nuk është e vërtetë siç përshkruhet në dispozitiv të aktakuzës, pasi nuk ka lidhje me kryerjen e kësaj vepre penale që akuzohet se e ka kryer pasi kam qenë i sëmur por te mjeku nuk ka shkua, por ishte dalë nga shtëpia që të shkoj te një barnatore që të blej barna dhe në rrugë po sa ka dalë është arrestuar nga policia dhe e kanë dërguar në Stacionin Policor në Ferizaj dhe aty është intervistuar ku kanë hartuar procesverbal dhe ka deklaruar se me rastin që po intervistohet nuk është e vërtetë se paskam kryer vjedhjen mbrëmë rreth orës 23:00 në rrugën "Vllezërti Gërvalla" në Ferizaj dhe ju ka thënë policisë se për këtë vjedhje po njoftohem nga ju. Po ashtu edhe në shqyrtimin e sotëm gjyqësor dëgjova edhe dëshmitarin [REDAKTUAR] por dëshmia e tij nuk është e vërtetë, edhe të dëmtuarit i them se nuk i ka bërë vjedhje në shtëpinë e tij.

I dëmtuari [REDAKTUAR] në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar atë ditë isha në punë dhe posa jam kthyer nga puna isha i lodhur dhe unë kam marruar disa dru nga jashtë për ti shti brenda ane shtëpi dhe diku rreth orës 22:00 kam shkuar me bashkëshorten për të fjetur në katin e dytë të shtëpisë, ku drena e hyrjes në shtëpi e ka mbyllur, mirëpo por sa kam filluar te flejë kam dëgjuar se dera e dhomës ton u hap dhe në ndërkoha kur është hapur dera kam vjetur një person që kishte vure në gojë një shkërbesë me drita, dhe me njëherë jam ngritur, dhe kam zbritur shkalleve të korridorit të shtëpisë poshtë tek dera e hyrjes e pash të hapur dhe me pas e kam vërejtur se edhe dritarja ishte e hapur e cila gjendet nënë shkalle, ka dal në oborr të shtëpisë të cilën e kam të rrethuar me rrethore, dhe kam par një person nga pjesa e mbrapme -shpinës, dhe ka ikur dhe nuk ka mundur që ta vërej përpara se kush ishte, por në rrugë kryesore ka parë [REDAKTUAR] dhe i njëjti me tha mos u ngut se aty që u largu më parë nga oborri i shtëpisë së juaj ishte [REDAKTUAR] dhe menjëherë kam ftuar policin në lidhje me rastin dhe i kamë dhen emrin atë cilin ma tregoj [REDAKTUAR]. Kur u ktheva në shtëpi nga dhoma ime kalove në dhomën e fëmijëve dhe e shikoj fjokën e orendive ku në te ka pasur stoli prej ari, bizhuteri e gjësende tjera, ku mungojnë edhe çanta e vajzës ku në te kishte bizhuteri rruza etj. Pos gjerave të cekuar më larte edhe telefoni Smasung e ka marrë, vlera e dëmit ka qen rreth 1500-2000 Euro.

Dëshmitar [REDAKTUAR] në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se atë mbrëmje kam pasur mysafirë por rreth orës 22:30, kam dal ti përcjelli në rrugën kryesore e cila është me ndriçim, ku shtëpia e të dëmtuarit [REDAKTUAR] është shume afër me shtëpinë tim dikur rreth 50 dhe ka parë [REDAKTUAR] që është i pranishëm në sall duke dalur nga rrethoja e oborrit të shtëpisë së Rrahmanit në rrugën kryesore dhe ka ecur nëpër trotuar por në duar nuk ka pasur asgjë e njof mirë pasi me te jemi fqinjë dhe jemi rritur së bashkë, dhe pas shkuarjes së [REDAKTUAR], nga oborri i vetë ka dalë i dëmtuari [REDAKTUAR] ku më tha [REDAKTUAR] me ka hyrë

dikush ne shtëpi dhe iku e më ka vjedhur e unë i thash se tash e pash [REDAKTUAR] qe dulë nga oborri i shtëpisë tanë por në duar nuk ka pasur asgjë. Në pyetjet e të pandehurit [REDAKTUAR] parashtruar dëshmitarit në vazhim dekalron se ju jeni kanë atë natë kur keni dalur nga oborri i shtëpisë së [REDAKTUAR] dhe ke dalur ne rrugën "Kadri Zeka" dhe ke vazhduar rrugën jo nga qyteti por anën tjetër nëpër trotuar, pasi unë kisha musafir dhe dola që ti përcjelli dhe rruga kishte ndriçim dhe ti ishe kjo është e vërtet dhe nuk mundem mos ta them të vërteten pasi për këtë jam ftuar nga gjykata.

Gjykata me propozimin e të pandehurit kishte ftuar edhe dëshmitarin [REDAKTUAR] policin hetues, pasi është njoftuar lidhur me rastin i njëjti deklaroi se nuk është marrë me këtë rast dhe nuk ka dioni kurëse me rastet tjera që ka kryer [REDAKTUAR] është marrë.

Gjykata pas zbatimit të provave dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe të gjitha në tërësinë e tyre konformë dispozitave ligjore të nenit 8 dhe 361 pag.1 dhe 2 të KPPRK-së vërtetoi gjendje të fakteve si në dispozitiv të aktakuzës.

Nga dëshmia e të dëmtuarit [REDAKTUAR] dhe dëshmitarit [REDAKTUAR] vërtetohen faktet se i akuzuari ditën dhe kohën kanë qenë në vendin siç përshkruhet në aktakuzë ka kryer veprën penale që i vihet në barrë, kjo nga mbrojtja e të akuzuarit të parë, e në veçanti nga dëshmia e dëshmitarit [REDAKTUAR] ka parë të akuzuarin [REDAKTUAR] duke dal nga oborri i shtëpisë së të dëmtuarit.

Nisur nga këto fakte dhe prova është vërtetuar në mënyrë të padryshimtë se ne veprimet e të akuzuarve ekzistojnë tiparet e veprave penale të cilat i vihen në barrë për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga nenin 327 par.1 nën paragrafi 1.1 të KPRK-së.

Konkretisht, sa i përket objektit të veprës penale, veprimet e kundërligjshme të kryera nga i pandehuri [REDAKTUAR] kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për ruajtjen dhe paprekshmërisë e pronës dhe të drejtave pasurore të personave fizike e juridike nga veprimet kriminale të mbrojtura nga legjislacioni ynë penal, dhe si të tilla paraqesin rrezikshmëri shoqërore.

Nga ana objektive, kjo vepër është kryer nga i pandehuri [REDAKTUAR] me veprime aktive të kundërligjshme, duke i ju vjedhur fshehurazi të dëmtuarve të sipër cekur sendet e përshkruara si në dispozitiv.

Nga ana subjektive këto veprime janë kryer nga i pandehuri [REDAKTUAR] dhe me dashje direktë dhe me qëllimin të përvetësimit të kundërligjshëm për vete të pasurisë së luajtshme të tjetrit, pasi i pandehuri jo vetëm që ka parashikuar pasojat e veprimeve të tyre, por edhe ka dëshiruar ardhjen e tyre, ç'ka rezulton nga tërësia e rrethanave të kryerjes së veprave penale.

Mbrojtjen e të akuzuarit [REDAKTUAR] e vlerëson në tersi si të pa bazuar nga se është në kundërshtim të thellë me prova tjera, e në veçanti me ballafaqimin e tij me dëshmitarin [REDAKTUAR] ku duke e shquar në sy i thotë: se unët të kamë parë atë natë duke dalur nga oborri i shtëpisë së të dëmtuarit, ku edhe i dëmtuari deri të rrethoja e ka përcjellë por nuk e ka parë në

fytyrë por fqiu i tij që është në cilësinë e dëshmitarit i ka thënë se ky person që ka dalë nga dera e oborrit të i shtëpisë së juaj ishte [REDAKTUAR].

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73, 74 dhe 75 të KPRK-së, si rrethanë lehtësuese gjeti se është i gjendje jo të mirë shëndetësore, i gjendjen ekonomike të dobët, sjelljen korrekte gjatë procedurës, ndërsa rrethana rënduese mori se i njëjti është recidivist i veprave penale të natyrës së ngjashme përkatësisht është i dënuar me aktgjykime të formës së prerë për vepra penale të vjedhjeve ku edhe është në vuajtje të dënimit, si dhe nga historiku i siguruar nga Policia e Kosovës- Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj që gjendet në shkresa e kësaj lënde penale ka të kryera shumë vepra tjera penale.

Dënimi i shqiptuar sipas bindjes së kësaj gjykate janë në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore, shkallën e përgjegjëses penale të pandehurit do ti shërbej preventives së përgjithshme që ti parandaloj personat tjerë në kryerjen e veprave penale si dhe preventives individuale që të akuzuarit në të ardhmen mos të kryejnë vepra penale me çka është edhe qëllimi i dënimit nga nen. 41 i KPRK-së.

Kërkesën pasurore juridike e ka parashtruar i dëmtuari [REDAKTUAR] nga Ferizaj, rruga Kongresi i Lushnjës “,në seancën e shqyrtimit gjyqësor.-

Në kuptim të nenit 458 dhe 463 të KPPRK-së aprovoi kërkesën pasurore – juridike me dhe se ka vlera të caktuara siç përshkruhet në dispozitiv, gjykata e obligoi që ti a kthej të dëmtuarit sendet e vjedhura ose në të kundërtën t’ia kompensoj kundërvlerën në të holla në shumë prej 1500 Euro,-

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale- paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nënpar. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,

P.nr.874/14 me datë 17.10.2018

Zyrtare Ligjore  
Kadishe Shabani



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.